

# URANIUMI I VARFËRUAR DHE NDOTËSIT TJERË RREZIK SERIOZ PËR KOSOVËN

*Shkruan: Sejdi Veseli*

Po mbushen tetë vete të plota nga përfundimi i luftës së armatosur kundër shkelësve të barit mbi varret e të parëve tanë, të cilët na e lanë trashëgimi truallin tonë. Këtë luftë e zhvilluam nën Flamurin e Famëmadhes Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të mbështetur nga ajri nga forcat e Aleancës Veriatlantike - NATO.

Është rregull i mirënjohur, se pas përfundimit të luftërave, të bëhet edhe vlerësimi i përmasës së dëmtimeve në njerëz, bagëti të mira materiale në përgjithësi, të shkaktuara nga veprimet luftarake të kundërshtarit. Andaj, edhe ne shqiptarët e Kosovës (Unmikistan) e kemi ndie detyrë parësore eliminimin e dëmtimeve të mëdha dhe të shumëllojshme që na janë shkaktuar nga thundrakët pushtues serbo-çetnike, me armatimet supermoderne të tyre.

Duhet të konstatojmë me dhembje në shpirt, se edhe ato sanime teknike që i kemi bërë në terrenet e djegura rënd, përveç në rastet kur kemi pasur të bëjmë me shtëpitë e minoritarëve serb, ku i kemi bërë të gjitha veprimet për mrekulli, pa e lodhur mendjen se çfarë kanë bërë familjarët e tyre gjatë luftës, për popullin shumicë ishin gjysmake, për mos me thënë shkel e shko. Nuk përjashtohet mundësia, që edhe familjeve të paramilitarëve serbo-çetnik u kemi ndërtuar shtëpi moderne dhe ua kemi mobiluar me mobile të reja, thjesht u kemi siguruar një jetë komfore, më të mirë se ajo që e kanë pasur para luftës. Ndërsa shumicën e luftëtarëve të lirisë dhe familjet e shumta shqiptare, të cilëve ua kanë djegur shtëpitë pushtuesit (ndofta po ata që u kemi siguruar plëng dhe shtëpi), i kemi lënë të presin për një kulm mbi kokë dhe që gjallojnë nën plastmasë, duke u ballafaquar me acarin e dimrave dhe lagështinë.

Por me këtë shkrime timen kam për qëllim të përiqem të shpalosë një problem, i cili gjeneron në vazhdimësi rrezik të madh për shëndetin, jo vetëm për gjeneratat e sotme të popullit, por edhe për ato që do të vinë për disa shekuj më pas. Pra, e kam fjalën për rrezikun që paraqet ndotja e Truallit tonë atëmëmëdhetar lëndë radioaktive, biologjike dhe helme të ndryshme luftarake.

Jemi dëshmitar i një realiteti të hidhur, se deri në ditët tona, nga të kompetentët për shëndetësi dhe për mbrojtjen e ambientit, të cilët dje figuronin si “zyrtar të lartë” të kinse IPVQK (e që në realitet u vetë-dëshmuar se nuk ishin tjetër pos servil të unmikistanezëve...), dhe ata të mëvonshmit që fryheshin më mandatin që ua dha populli me votën e tij, jo vetëm se nuk është ndërmarrë as edhe, një hap për eliminimin e këtij rreziku, por as që është diskutuar seriozisht për te, ngase u kanë thënë shefat e tyre ndërkombëtarë, harrojeni këtë punë, se ky rrezik nuk ekziston.

Nëpërmes këtij shkrimi të cili po e ribotoj (me pak ndryshime) u bëjë thirrje publike, të gjithë atyre që e konsiderojnë veten kompetent, për të ndërmarrë hapa konkrete për detektimin ABK të hapësirës kosovare dhe dekontaminimin e asaj çka mund të dekontaminohet, në rend të parë nga ndotësit atomikë (uraniu i varfëruar), kimik (dioksina) dhe biologjik (shkaktarë të sëmurjeve ngjitëse e të cilët bëjnë pjesë në arsenalin e armëve biologjike, si p.sh. Tularemia...), me të cilët u kontaminua kjo hapësirë gjatë periudhës së luftës, si nga ana e ushtrisë pushtuese serbo-çetnike, ashtu dhe nga fushata e bombardimeve të NATO-s, ndaj pozicioneve, armatimeve dhe pikave strategjike të pushtuesit.

## **Si erdhi deri të kontaminimi radioaktiv?**

Përgjigjen në këtë pyetje do ta filloj me këtë citim:

“Më 22 prill (1998 v.ime) forcat serbe përdoren për herë të parë predhat radioaktive kundër trupave të UÇK-së... përdorimi i predhave me material radioaktiv brenda territorit shqiptar synonte të qëllonte mbi popullatën civile... përdorimi i armëve të tilla u shtua gjatë muajit maj...”

James Pettifer dhe Miranda Vickers “Çështja shqiptare – Riformëzimi i Ballkanit”, faqe 355, botimi shqip nga Bota shqiptare dhe Edicioni “Libri”, Tiranë-New York, 2007

Siç dihet, ushtria pushtuese serbo-çetnike ka pasur në posedim DU municione që nga viti 1989, të prodhimit rus e më vonë ato të prodhimit serb, në “Krušik” të Valevës dhe Sloboda të Çaçakut.

Dëshmia më e mirë që vërteton faktin, se në përdorim të ushtrisë serbe gjenden DU municione, është aksidenti në Fabrikën e armatimeve ”Krushik” të Valevës, ku u rrezatuan 4 punëtor serb, të cilët punonin në këtë fabrikë. (www,b-92.net).

Siç theksova më lartë, Ushtria pushtuese serbo-çetnike, që nga viti 1989 ka në posedim raketa ajër-ajër, me kokë nukleare dhe me peshë prej 3.5 e 6 kg dhe të cilat posedojnë 1.6 kg DU, në formë të shufrave, si ato të prodhimit rus, ashtu dhe ato të modifikuara në fabrikën “Krushik” të Valevës, me shenjën dalluese R60 MK.

DU-depleted uranium (uraniumi i varfëruar), është një nusprodukt i prodhimit të karburantit nuklear, pra si tepricë e uraniumit të fisnikëruar, i cili shfrytëzohet për prodhimin e bombave nukleare.

Uraniumin e varfëruar, OKB e klasifikojnë si “ një metal të rënd dhe jo stabil”, i cili emeton tri lloje të radioaktivitetit jonik:alfa, beta dhe gama.

Në fabrikat serbe për prodhimin e armatimeve “Krushik” të Valevës, “Slloboda” të Çaçakut, “Zastava” të Kragujevcit dhe “Prvi Partizan” të Uzhicës, uraniumi i varfëruar (me siguri prodhim i reaktorit “Vinça”), shfrytëzohet për prodhimin e municioneve blindëshpuese të këtyre kalibrave: 7,62 mm, 7.9 mm, 12.5 mm, 12.7 mm, 20 mm, 25 mm, 30 mm, 105 mm, 125 mm, 155 mm, si për prodhimin e kokave të raketave tokë-ajër, tokë-tokë dhe ajër-ajër, të të gjitha kalibrave, përfshi këtu edhe ato të radiusit të gjatë të veprimit!

Këto municione u shfrytëzuan dhe shfrytëzohen si nga Ushtria serbe, ashtu dhe për eksport.

Me këto raketa janë të armatosur aeroplanët luftarak serb, MIG 21, MIG 29, Orao 2, Supergaleb...

Ushtria serbe, përveç të tjerave, ka pasur dhe ka në posedim DU municione për tankun e prodhimit të vetë, M-84(sipas modelit rus T-74).

DU-municioni që përdoret nga tankësi M-84 njihet me shkurtesën APFSDS 125 mm. Por në përdorim të tankësit M-84, që prej momentit të modifikimit të tij nga modeli rus T-72, gjendet edhe predha me penetruar nga volframi.

DU-municionet bashkëkohore me predha nënkalibrore, janë të destinuara për t’u përdorur nga topat e tankeve dhe topat kundër tank, për luftime kundër mjeteve të blinduara luftarake, në largësitë prej 2000 deri në 3000 metra.

Këto municione janë të konstruara sipas principit të shfrytëzimit të energjisë vetanake kinetike e cila gjatë kontaktit të predhës me cakun, së pari deformohet dhe më pastaj e tejshpon pengesën. Gjatë shpërthimit brenda objektit, copëzat e predhës dhe të blindës paaftësojnë ekuipazhin dhe stabilimentet vitale të mjetit të goditur,duke e nxjerrë atë nga formacioni luftarak i kundërshtarit.

DU-municionet kundërtank me predha nën kalibrore janë shumë më efikase, në krahasim me ato klasiket, të cilat lansohen nga tytat e topave të tankeve dhe të atyre kundërtank dhe njihen si: predhat pancir dhe komulative.

Në bazë të konstruktimit specifik masa e predhës është zvogëluar prej 1/3 deri në ¼ të masës së atyre klasike. Kjo veti mundëson shpejtësi të madhe fillestare të udhëtimit të predhës nën kalibrore, prej 1.400 deri në 1.800 m/sek. Përveç të tjerave, bartësi i predhës përbën afro 30% të masës së përgjithshme të predhës dhe ndahet nga ajo, menjëherë pas daljes së saj nga tyta lansuese, kështu që e rritë radiusin e veprimit të predhës, prej 1000 metra në 2000 deri në 3000 metra. Shih foto 1



Foto 1: Ndarja e bartësit të predhës UV, menjëherë pas daljes nga tyta e lansuesit

Për ndërtimin e bërthamës së këtyre predhave të destinuara për luftë kundër mjeteve të blinduara përdoren metalet e rënda dhe uraniumi i varfëruar dhe për këtë njihen me emërtesën e njohur, si DU municione.

Metali i fortë që përdoret për ndërtimin e bërthamës së këtij lloji të predhave, është një legurë e përbërë prej dy elementëve, nga volframkarbidi(WC) dhe kobalti (Co) ose nga nikeli(Ni), me masë specifike afro 13 deri 14 gr/m<sup>3</sup>.

Metali i rëndë është një legurë e përbërë nga tri elemente, nga volframi (W), hekuri (Fe) dhe bakri (Cu) ose nga volframi (W), nikeli (Ni) dhe hekuri (Fe), më masë specifike prej rreth 18 g/m<sup>3</sup>.

## Si duken municionet DU?




Fig. 2 Municionet UV


Këto predha dallojnë nga predhat tjera të artilerisë, edhe nga fakti, se nga koka e tyre del një pykë me ngjyrë të përhimët në të mbyllur, me gjatësi prej afro 20 cm. Maja penetruese e kësaj pyke ka një gjatësi prej afro 3 cm dhe ka shkëlqim të ngjashëm me atë të argjendit.

Transportohet në ambalazh të posaçëm, në të cilat ka vend për dy predha, në të cilën janë të vendosura shenjat e rrezikut nga radioaktiviteti dhe shenja e uraniumit 238(uraniumit të varfëruar). ([www.cgocable.net](http://www.cgocable.net))



Xhafer Buzoli në një vend të goditur nga raundet e uraniumit të varfëruar në Rikavac. (Foto: Phil Miller / DCUK)

### Where did NATO fire depleted uranium in Kosovo?



Ky municion është përdorur në zonën e Shalës, Llapit, Drenicës dhe të Dukagjinit, Prishtinës, si dhe në zonën kufitare Shqipëri Londineze-Kosovë, në regjionin e Kukësit dhe Bajram Currit.

Ky municion është përdorur kundër fortifikimeve, sidomos në objektet e ndërtuara me gurë(kullat shqiptare) dhe beton arme dhe ku kanë qenë vatrat e fortifikuara të zjarrit.

### **Cilat janë pasojat shëndetësore nga kontaminimi me UV?**

Rreziku më i madh nga DU-municionet fillon në momentin e shpërthimit të predhës. Në kontakt të predhës me cakun, krijohet një temperaturë e lartë, prej afro 3400 gradë Celsius. Pas perforimit të pengesës, predha shndërrohet në formë të pluhurit, që digjet në kontakt me ajrin, duke krijuar oksidin e uraniumit dhe shndërrimin e tij në aerosol. Në varshmëri të drejtimit dhe të forcës së erës, ky pluhur mund të kontaminojë hapësirë të madhe.

Personat që inhalojnë këtë pluhur mund të pësojnë dëmtime serioze. Serioziteti i këtyre dëmtimeve është në varshmëri të plotë nga forma e oksidit të uraniumit, me të cilin është kontaminuar personi.

Dihet se ekzistojnë dy forma të këtij oksidi.

Nëse personi e ka inhaluar formën e gaztë të UV, ai mund të lirohet nga ai duke e nxjerrë nga organizmi, me anën e djersitjes dhe urinimit.

Nëse personi është kontaminuar me formën “qeramike” të UV, ky kontaminuat mund të qëndrojë në ndonjë ind për një kohë të gjatë e kjo do të thotë, se personi që është kontaminuar me këtë formë të oksidit të uraniumit, do të ketë një burim rrezatimi të përhershëm në organizmin e tij dhe do të ballafaqohet me të gjitha pasojat e rrezatimit radioaktiv.

Rrezatimi alfa që posedon UV ka një forcë të madhe depërtuese, ai shkatërron edhe materialet gjenetike, kështu që pasojat barten tek pasardhësit. Jonizimi i emetuar nga UV shkakton ndryshime të pariparueshme në molekulat dhe në trashëgimin gjenetike të qelizave dhe si pasojë shkakton një rrezik prej formave të kancerit.

UV është më i rrezikshëm se uraniumi natyror, ngase ai oksidohet dhe është i tretshëm në ujë, duke depërtuar, në shtresat ujë bartëse të tokës.

Me pasojat e detonimeve të DU municioneve të shumta në Kosovë, gjatë viteve 1998 dhe 1999, të shkrepura si nga ushtria serbe, ashtu dhe nga aviacioni i NATO-s (prej 24 marsit e deri me 10 qershor të vitit 1999) si duket kemi filluar të ballafaqohemi më herët, se sa ka mund të paramendohet (nëse është paramenduar) nga kompetentet e mbrojtjes së ambientit dhe të shëndetësisë kosovare.



*Një bunker i ushtrisë jugosllave në Gjakovë është goditur me uranium të varfëruar. (Foto: Phil Miller / DCUK)*



*Avionët amerikanë hodhën 655 fishekë me uranium të varfëruar në këtë vend në liqenin e Radoniqit. (Foto: Phil Miller / DCUK)*

Në vitin 2001, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar pranoi se mijëra trupa britanike që shërbyen në Kosovë gjatë konfliktit të udhëhequr nga NATO në 1999 ishin në rrezik nga efektet e DU, pasi një paralajmërim shëndetësor nuk arriti të arrinte ushtarët.

Raportet e deklasifikuara se gjykatat italiane po gjejnë në favor të veteranëve që u zhvilluan nga kanceri pasi u ekspozuan ndaj uraniumit të varfëruar ndërsa shërbenin në Ballkan në vitet 1990.


Përdorimi i NATO-s i uraniumit të varfëruar (DU) në Kosovë nuk u konfirmua deri në vitin pas luftës, mes panikut për 'sindromën ballkanike'. Paqeruajtësit italianë, të cilët morën kontrollin e shumë bazave të bombarduara të ushtrisë jugosllave, po bien me leuçemi.

Në mars të vitit 2000, shefi i NATO-s, kolegu laburist George Robertson, i tha me vonesë Kofi Annan të OKB-së se "afërsisht 31,000 fishekë" të DU-së ishin qëlluar "në të gjithë Kosovën gjatë afërsisht 100 misioneve". Ai tha se arma vendosej "sa herë që A-10 angazhohej me forca të blinduara", duke iu referuar "tankbusterit" të Warthog të forcave ajrore amerikane.

Pas muajsh mashtrimesh të brendshme intensive për marrjen e hartave më të sakta, ata kaluan 24 ditë gjatë viteve 2000-2001 duke vëzhguar Kosovën për kërcënimin e dyfishtë të paraqitur nga DU: rrezatimi dhe toksiciteti i metaleve të rënda – të cilat mund të shkaktojnë kancer ose defekte të lindjes.

Shumë varet nga gjetjet e tyre. Një rezultat negativ do të minonte kredencialet humanitare të NATO-s dhe do të pengonte kthimin e refugjatëve nga azili i tyre i përkohshëm në Evropën Perëndimore.

**New cancer cases in Kosovo, 2021**



Map: Declassifieduk • Source: Kosovo Agency of Statistics • Map data: © OSM • Created with Datawrapper

Droja e shprehur nga disa njohës të efekteve të uraniumit të varfëruar, se populli i Kosovës do të ballafaqohet pas 5 vjetësh me pasojat e para nga bombardimeve me DU municione, mjerisht po vërtetohet, ngase numri i madh i të sëmurave nga sëmurjet malinjë, mjerisht me epilog fatal, ka filluar të bëhet dukuri e përditshme.

Përveç rritjes së numrit të atyre që po preken nga format e ndryshme të sëmundjeve malinje, shqetëson fakti se ky numër dominohet nga të rinjtë.

Sipas pikave të goditura nga predhat DU, popullata e regjionit të Dukagjinit është më e rrezikuara, sidomos nga pjesa që kufizohet me kufirin shqiptaro-shqiptar. Siç dihet, nga ushtria serbe jo vetën se janë goditur me predha DU caqe të shumta në rrethin e Deçanit dhe Gjakovës, por edhe pjesë të rrethit të Bajram Currit dhe Kukësit.

Është për të dyshuar seriozisht në profesionalizmin dhe sidomos në etikën e disa punëtorëve të disa organizatave ndërkombëtare, të cilët duke u bazuar vetëm në disa hulumtime sipërfaqësore dhe të vonuara shumë (sa për të arsyetuar donacionet e majme që marrin për këto punë të tyre "hulumtuese"), që po kanë fytyrë të deklarojnë, se DU është i pa rrezikshëm për shëndetin e popullatës, së vendeve ku janë përdor municionet e prodhuara nga kjo lëndë shumë e rrezikshme. Në kuadër të këtyre organizatave prijnë UNEP dhe simotrat e saj.

Është e kuptueshme se përdoruesi i këtij lloji të municioneve nuk pranon se ato paraqesin rrezik për rrethinën, sepse sipas normave ndërkombëtare, përdoruesi i mjeteve të rrezikshme është i obliguar të paguajë shpenzimet financiare për detektimin dhe dekontaminimin dhe, këto shpenzime janë shumë të mëdha.

“Në Malin e Zi fqinj, ku NATO gjuajti uranium të varfëruar në vetëm një vend, kostot e pastrimit janë të frikshme. Për të dekontaminuar 480 fishekë, të cilave u deshën vetëm 12 sekonda për t'u gjuajtur, Mali i Zi shpenzoi mbi një çerek milion dollarë amerikanë dhe i kushtoi 5,000 ditë pune.

Kosova ka më shumë se 100 vende të tilla.”

Është në natyrën e seriozitetit shkencor dhe të etikës profesionale dhe njerëzore, që për çështje të pa studiara mirë të jepen supozime, se efektet e tyre janë, apo nuk janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut në veçanti dhe të botës shtazore në përgjithësi.

Realisht, numri i të sëmurave nga format e ndryshme kanceroze, sidomos të mushkërive, gjirit, grykës, lëkurës dhe leukemive është në rritje dhe me përfundime fatale. Çka është më keq në numrin e përgjithshëm të të prekurve nga kjo fatkeqësi, grupmosha e re ka filluar të shënojë rritje.

Mjafton të bëhet kujdestari për një muaj rresht në varrezat e Prishtinës, dhe të mësosh një fakt shumë shqetësues, se më shumë se gjysma e atyre që varrosen, janë të diagnostifikuar se kanë lënguar nga sëmurjet kancerogjene dhe të moshës nën 60 vjeçare.

Duhet konstatuar me keqardhje, se këtë të dhënë mund ta sigurosh vetëm në këtë mënyrë, ngase institucionet tona shëndetësore, nuk e kanë parë të arsyeshme të hulumtojnë këtë dukuri, andaj edhe mungojnë të dhëna të sistemuara profesionalisht.

Kohëve të fundit janë shpeshtuar rastet e aborteve dhe lindjeve të fëmijëve me anomali kongjenitale, sidomos nga zonat e prekura nga bombardimet gjatë luftës.

Gjithashtu, duhet konstatuar se edhe tek kafshët shtëpiake, janë shpeshtuar sjelljet në jetë të të vegjëleve të tyre me anomali të ndryshme.

Kjo nuk i shqetëson kompetentët vendor, ngase ata janë të dhënë pas tenderëve, honorareve dhe luftës për poste drejtuese... etj.

Përball këtij realiteti të hidhur, pa u frikësuar së po merremi me paragjykime, na imponohet dyshimi i bazuar, se shkaktar i krejt kësaj që po ndodhë, nuk është tjetër pos pasojë e kontaminimit me UV (uranium të varfëruar). Ky dyshim mund të kontestohet vetëm pas hulumtimeve të mirëfillta dhe të gjithanshme shkencore, çdo kontestim tjetër, padyshim bëhet për qëllime politike. Fshehja e këtij rreziku shumë të madh para popullit, siç po bëhet që 8 vjet, është turp për ata që dinë çka është turpi!

Kur e terë bota shkruan me të madhe për rreziqet me të cilat ballafaqohet populli i Kosovës, sidomos nga ndotësit e ambientit, të cilët u hodhën nga të huajt gjatë kohës, kur populli shqiptar luftonte heroikisht për të shpëtuar nga bishat serbo-çetnike, të cilat synonin shfarosjen e tij, hajnat e farës tonë, mafiozët, “ekspertet” me diploma false, të pa aftit, të verbuar pas interesave të tyre personale dhe të mujsharëve të tyre heshtin dhe e mbulojnë të vërtetën.

Populli jeton nëpër terrene të kontaminuara dhe deri në ditët e sotme, askush nga “shkencëtarët” tanë zhurmajnë nuk i tërhoqi vërejtjen për rrezikun që i kanoset. Bile disave u konvenon fshehja e këtij rreziku serioz para populli, nga se ky është një investim për të pasur fitime të mëdha në ambulancat private dhe gjatë procedurave për dërgimin e fatkëqijve për shërim në qendrat e specializuara mjekësore jashtë vendit.

Po të ishte ndryshe, me siguri do të bëheshin hulumtimet e mirëfillta në terren, me qëllim të identifikimit të regjioneve të kontaminuara me uranium të varfëruar, si dhe shkalla e ndotje së terrenit me materie helmuese, si p.sh. me dioksinë e cila për nga shkalla e rrezikshmërisë për shëndetin e popullatës, radhitet menjëherë pas mjeteve radioaktive.

Si pasojë e mosinteresimit të kompetentëve nuk është bërë dekontaminimi as edhe i një centimetri katror të terreneve të Kosovës, edhe ato të cilat janë para hundëve të IPVQ-ve, të cilat ishin goditur nga predhat DU dhe as ku kanë shpërthyer depot ushtarake (p.sh. në Llukar) në të cilat përveç DU municioneve ka pasur edhe predha të mbushura me helme luftarake, si dhe depot e karburanteve për nevojat ushtarake, si p.sh në Bardhosh dhe në Arbëri.

Gjatë bombardimeve janë asgjësuar një numër i madh i stabilimenteve kimike dhe petrokimike dhe është përdorur municioni me uranium të varfëruar. Këtë fakt e ka pranuar edhe ish Sekretarin i Përgjithshëm i Paktit NATO Gjorgj Robertson.

Pasojat e këtyre kontaminimeve si pasojë e përdorimit të DU municioneve vërehen me të madhe dhe me siguri do të vërehen edhe nesër. Andaj duhet të formohet një komision ekspertësh, nga të jashtëmit dhe vendorët për të bërë hulumtimet e nevojshme në terren dhe në bazë të tyre të propozojë masat, të cilat duhet të ndërmerren, së pari për dekontaminimin e terrenit dhe masave tjera sanuese.

Gjatë këtij hulumtimi duhet të bëhet diferencimi i qartë, se cilat terrene i ka kontaminuar ushtria serbe dhe cilat aviacioni i NATO-s. Kjo punë mund të bëhet lehtë, në bazë të mbetjeve të municioneve të detonuara dhe në bazë të hartës, në të cilët janë pasqyruar të gjitha objekte e goditura nga aviacioni i NATO-s me DU municione. Kjo mund të dëshmohet edhe kur të krahasohen urdhrat e eskadrileve sulmuese për të krye veprime në terrenin e Kosovës, ndaj caqeve të ushtrisë serbe. Kjo gjithashtu mund të dëshmohet edhe në bazë të dokumentacionit të armëtarëve të cilët i kanë krye veprimet e armatosjes së avionëve para se të niseshin për detyrë luftarake në terrenin e Kosovës.

Projekti për sanimin e gjendjes duhet të mbështetet nga shkaktarët e kontaminimit të terrenit, ngase projektet e tilla jo vetëm se kushtojnë shumë, por ata duhet të detyrohen si masë dënimi, ngase përdorimi i këtyre mjeteve të rrezikshme është i ndaluar nga OKB.

Sa është evident rreziku nga kontaminimi me agjens radioaktiv dhe helme kimike, tregojnë këto fakte:

Fillimisht si ushtarët e KFOR-t, nëpunësit e UNMIK-ut, OSBE-së dhe organizmave tjerë ndërkombëtar të instaluar në Kosovën e pasluftës, nuk i kanë shfrytëzuar gjërat ushqimor të prodhimit vendor dhe as ujin e pijes, të gjitha i kanë sjellë nga jashtë.

Me 19 janar 2001, Në mbledhjen e hapur të KS të OKB, në të cilën është diskutuar për Kosovën është iniciuar edhe diskutimi në lidhje me municionet që përmbajnë në vete uranium të varfëruar, të cilat i ka përdorur NATO gjatë fushatës së bombardimeve ndaj caqeve të përzgjedhura në territorin e Serbisë dhe Kosovës.

Disa vende anëtare të KS të OKB, kanë kërkuar që kjo çështje të hulumtohet drejt dhe mirë dhe të ndërmerren masat përkatëse për sanimin e gjendjes, me kusht që të ruhet edhe personeli ushtarako civil ndërkombëtar nga pasojat e këtyre municioneve të përdorura.

Gjatë hulumtimeve që u janë bërë rreth 300.000 veteranëve amerikan të luftës për çlirimin e Kuvajtit nga Iraku, të cilët kanë qenë të ekspozuar kontaminimit me uranium të varfëruar, është zbuluar ky element i rrezikshëm në urinën dhe në spermën e tyre.

Kosova është e kontaminuar përjetësisht me elementet radioaktive, të cilët janë shumë kancerogjene. Periudha latente kancerogjene, d.m.th. koha e inkubacionit të malinjiteteve është prej 5 e deri në 50 vjet. Mund të konstatohet me siguri se malinjitetet që lajmërohen sot në trupat e NATO-s dhe paqeruajtësit në Ballkan janë vetëm maja e ajsbergut.

Zgjedhja e vetme është sanimi i terrenit, nëpërmjet dekontaminimit të plotë të vendeve ku kanë goditur predhat DU, si dhe hapësirën e kontaminuar nga detonimi, në përputhje me radiusin e veprimit të tyre. Me një dekontaminim të tillë do të zvogëloheshin në minimum rreziqet për popullatën dhe kafshët shtëpiake nga një rrezik evident për shëndetin dhe jetën e tyre. Referenca: Shtypi evropërendimor dhe veçanërisht ai britanik (B.B.C)

**Për të dëshmuar seriozitetin e gjendjes, e shoh të mjaftueshme të citoj një pjesë nga raporti i IWRP BCR No 526, 15-Nov-04):**

### **Mosmarrëveshjet mbi matjen e ndotjes**

Por disa shkencëtarë thonë se problemi më i madh është mënyra e matjes së ndotjes.

Një shkencëtar i cili mendon se uraniumi i varfëruar është shumë më i rrezikshëm se sa mendohej më parë, është Dr. Chris Busby, i komitetit mbikëqyrës për uraniumin e varfëruar në ministrinë e mbrojtjes së Britanisë së Madhe.

Dr. Busby ka kryer disa studime në Kosovë, ku janë përdorur gjithashtu municionet me uranium të varfëruar. “UNEP thotë se sasitë e vogla të uraniumit të varfëruar në ajër janë të padëmshme, megjithatë kjo nuk është e vërtetë,” ka thënë ai për IWPR (Institute for War and Peace Reporting), duke shtuar se kjo nuk është e vërtetë,” ka thënë ai për IWPR, duke shtuar se sipas tij, “ata kanë përdorur mënyra të gabuara për të llogaritur rrezikun”.

“Modeli tradicional i rrezikshmërisë bazohet në një organ të trupit njerëzor ndaj një pjese të uraniumit të varfëruar,” shpjegon ai.

“Por kur një pjesë e uraniumit të varfëruar thithet, ajo që ndodh është se një pjesë shumë e vogël e indeve të trupit ekspozohet ndaj tij. Pra pasojat e uraniumit të varfëruar nuk duhet të maten bazuar në një organ të trupit, por vetëm në ato qeliza të prekura”.

Profesori Malcolm Hooper, një profesor i njohur i kimisë mjekësore në Universitetin e Sunderland, pranon se kjo është një mënyrë më e mirë e matjes së shkallës së ndotjes.

“Uraniumi i varfëruar është një rrezik për shëndetin e popullsisë lokale sepse pjesëzat e vogla të uraniumit të varfëruar depozitohen fillimisht në sistemin e ujërave. Më pas, kur del dielli, drita dhe nxehtësia i stimulon pjesëzat dhe ato ngrihen përsëri në ajër,” ka thënë ai për IWPR.

“Raporti i UNEP ka qenë i pasaktë shkencërisht. Ata e kanë vizituar zonën shtatë vjet më pas dhe zonat e vizituara prej tyre janë pastruar – mjetet e shkatërruara dhe pjesa më e madhe e municioneve janë larguar”.

Në fund, profesori Hooper kujton edhe rastin e ushtarëve italianë, të cilët kanë shërbyer në Bosnjë dhe Kosovë.

Sugjerimi i parë për një lidhje ndërmjet uraniumit të varfëruar dhe sëmundjes së kancerit ka qenë ai në lidhje me vdekjen e pashpjegueshme të një numri ushtarësh italianë të cilët kanë shërbyer atje.

Televizioni italian e ka quajtur Sindroma e Ballkanit dhe shtypi i huaj ka shkruar shumë mbi këtë temë duke shkaktuar një zhurmë të madhe në media.

Frika për pasojat e uraniumit të varfëruar në Bosnjë është shfaqur fillimisht në dhjetor të vitit 2000, kur është njoftuar vdekja nga kanceri e Salvatore Carbonaro, vetëm 24 vjeç.

Carbonaro ka qenë ushtari i gjashtë, i cili kishte qenë në Ballkan që ka vdekur nga kanceri dhe ndryshimi i tij nga pesë të tjerët këtë qenë se ai kishte shërbyer vetëm në Bosnje dhe jo në Kosovë.

Deri më atëherë, NATO nuk kishte pranuar se kishte përdorur municione me uranium të varfëruar në Bosnjë. Por në dhjetor të vitit 2000 ministri i mbrojtjes së Italisë, Sergio Mattarella, ka pranuar se aleanca kishte përdorur municione të tilla edhe në Bosnjë, duke shtuar se Italia është njoftuar për këtë vetëm në atë kohë.

Mattarella më pas ka urdhëruar nisjen e një hetimi, nën drejtimin e profesor Franco Mandelli, për të hetuar lidhjen e mundshme ndërmjet kancerit dhe uraniumit të varfëruar.

Një anëtar i ekipit të Mandellit, Dr. Martino Grandolfo, ka thënë për IWPR se ekipi kishte parë një rritje të madhe të sëmundjes së Limfomës së Hodgins – një formë e leucemisë në gjak.

“Përqindja e rasteve me Limfomën e Hodgins në radhët e trupave italiane, të cilët kanë shërbyer në Bosnjë dhe Kosovë është mbi dy herë më e lartë se sa ajo në radhët e ushtarëve, të cilët kanë shërbyer në Itali,” ka thënë ai për IWPR. “Por për momentin ne nuk e dimë arsyen e kësaj”.

Numri i veteranëve italianë të Ballkanit, të cilët kanë vdekur nga kanceri ka arritur në 27 në korrik të vitit 2004 – dhe disa mendojnë se shifra e vërtetë është edhe më e lartë.

“Numri i të vdekurve në fakt është 32 apo 33, dhe numri i atyre të cilët jetojnë ende të sëmurë me kancer është disa qindra,” thotë për IWPR, Falco Accame, një ish oficer i marinës ushtarake dhe studiues, i cili është drejtues i grupit të veteranëve të Italisë, Anavafaf.

Reagimi publik ka detyruar qeverinë të pranojë ngritjen e një komisioni parlamentar në senatin italian për hetimin e pasojave të uraniumit të varfëruar.

Por Accame ka thënë për IWPR se ndërkohë, përveç kompensimit të paguar familjeve të ushtarakëve të vdekur, shteti nuk ka pranuar zyrtarisht asnjë lidhje ndërmjet uraniumit të varfëruar dhe kancerit.

“Si në rastin e problemeve shëndetësore nga përdorimi i duhanit apo asbesti, ne nuk mund të jemi të sigurt që uraniumi i varfëruar është përgjegjës për vdekjen e këtyre ushtarëve,” shton Accame. “Këtu, ne flasim vetëm për një mundësi që uraniumi i varfëruar të ketë ndikuar në sëmundjet kanceroze”.

Megjithatë, mungesa e dëshirës së zyrtarëve për të pranuar ekzistencën e një lidhjeje ndërmjet uraniumit të varfëruar dhe kancerit mund të ndryshojë.

Në një vendim të rëndësishëm të gjykatës së Romës më 10 korrik 2004, urdhërohet ministria e mbrojtjes së Italisë të paguajë 500,000 euro kompensim për familjen e Stefano Melone, një veteran i misioneve në Ballkan, i cili ka vdekur nga kanceri në vitin 2001.

Gjykata ka deklaruar se Melone ka vdekur “për shkak të ekspozimit ndaj substancave radioaktive dhe kancerogjene” dhe ka përmendur ndër to edhe uraniumin e varfëruar.



E veja e ushtarit të vdekur, Paola Melone, ka thënë për IWPR se ky është “një vendim historik”, duke shtuar se një gjykatë civile “tani ka pranuar se uraniumi i varfëruar është një substancë kancerogjene dhe e ka përmendur atë si një shkak të mundshëm të vdekjes” të burrit të saj.

“Ky rast ka krijuar një precedent dhe ne po organizojmë tani një konferencë në Itali për familjet e ushtarëve të tjerë të vdekur, për t’i ndihmuar ato në gjyqet e tyre,” shton ajo.

#### Referenca:

*James Pettifer dhe Miranda Vickers “Çështja shqiptare – Reformëzimi i Ballkanit”, faqe 355, botimi shqip nga Bota shqiptare dhe Edicioni “Libri”, Tiranë-New York, 2007*

*Phil Miller -In Kosovo, US-NATO 1999 Depleted Uranium Ammunition Bombings Still Causes Rising Cancer Cases –*

*Phil Miller -Courts across Europe have ruled that depleted uranium can cause cancer among troops.*

*Dr. Martino Grandolfo-(IWPR) Institute for War and Peace Reporting*

*Profesori Malcolm Hooper-(IWPR) Institute for War and Peace Reporting*

*PHIL MILLER - [declassifieduk.org/](http://declassifieduk.org/)*

*Sejdi Veseli – Vdekja e padukshme i kanoset Kosovës 11 prill 2007*

*Prishtinë, me 06 prill 2024*